



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1864/2 prot.

Tiranë, më 06 . 06 .2023

VENDIM

Nr. 44 , datë 06 . 06 .2023

PËR

“CAKTIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM, TË UNIVERSITETIT TË
MJEKËSISË, TIRANË”

Në mbështetje të neneve 49 dhe 51 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Kodit të Punës së RSh-së; të Kodit të Procedurave Administrative të RSH-së; të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; Udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IPAL” të Ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe Vendimit nr. 43, datë 05.06.2023 të Bordit të Administrimit, me qëllim vijimin normal të veprimitarisë në institucion, bazuar në kriteret ligjore për pozicionin e Administratorit të institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Znj. Marigo Jaupi, me pozicion “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, në Rektoratin e UMT-së, caktohet në pozicionin “Administrator i përkohshëm” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
2. Pezullimin e përkohshëm të Znj. Marigo Jaupi nga detyra “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, deri në përfundimin e procedurave të punësimit dhe emërimin e Administratorit të UMT-së;
3. Ngarkohet Znj. Marigo Jaupi të marrë masat përkatëse për caktimin e përkohshëm/shtesë në detyrë të një anëtari personel administrativ në Drejtorinë Ekonomike në UMT, i cili plotëson kriteret ligjore për detyrën “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike” dhe njëkohësisht Nëpunës Zbatues, deri në përfundimin e procedurave të punësimit dhe emërimin e Administratorit të UMT-së;
4. Vendimi i dërgohet për njohje dhe zbatim, Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Znj. Marigo Jaupi, si dhe njësisve kryesore të UMT-së;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR

ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFFERI

ENDRIT YZEIRAJ